



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIË**

Nr. 4034/prot.

Tiranë, më 05.07.2019

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1043, datë 20.07.2007.

**SHOQËRISË “PRODHIME KARBONIKE” SHA
Zona industriale, Bradashesh, Elbasan.**

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.**

Shoqëria “Prodhime Karbonike” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1043, datë 20.07.2007, për mineral hekur-nikel & nikel silikat, në objektin “Bitinckë”, Devoll, Qarku Korçë.

Nga struktura përgjegjëse e AKBN-së me shkresën nr.2612, datë 08.04.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.4034, datë 10.04.2019, është propozuar revokimi i lejes nr.1043, datë 20.07.2007, për mineral hekur-nikel & nikel silikat, në objektin “Bitinckë”, Devoll, Qarku Korçë, sepse nuk keni paguar të plota garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitet 2015 – 2016, 2017 – 2018, 2018 - 2019, duke mos respektuar kërkesat e nenit 31 të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij.

Për propozimin e AKBN-së, siç duket shoqëria juaj ka pasur dijeni përpara se të dërgohej shkresa që cituam mësipërm, prandaj keni dërguar shkresën me nr.57, datë 02.04.2019, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.3841, datë 04.04.2019 ku keni kërkuar rivlerësimin e vlerës vjetore të garancisë së rehabilitimit të mjedisit.

Me marrjen e shkresës të AKBN-së nr.2612, datë 08.04.2019 “Propozim për marrje mase revokimi”, të cilën shoqëria juaj e kishte për dijeni, keni përsëritur këtë kërkesë me shkresën tuaj 57/2 date 30.04.2019 protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.1034/1, datë 12.04.2019, ku kërkonit të njëjtën gjë.

Ne përgjigje tone për shkresën tuaj nr.57 date 02.04.2019 ju kemi thënë:

“Në pikën nr.7, neni 31, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përcaktohet:

“Zotëruesit e lejeve minerare të kërkim-zbulimit dhe të shfrytëzimit, brenda një periudhe njëvjeçare pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të paraqesin për shqyrtim e miratim planin e rehabilitimit të mjedisit, që përmban vlerën e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit përfundimtar të mjedisit. Struktura përgjegjëse duhet të përcaktojë vlerën e papaguar të kësaj garancie.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, është përcaktuar vlera e garancisë së rehabilitimit të mjedisit, si vlerë e përgjithshme e vjetore, për lejen që shoqëria juaj zotëron dhe kjo vlerë është miratuar me Urdhër të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr.144, datë 10.03.2014, të

cilën duhet ta kishit paguar për çdo vit. Nga ana juaj kërkohet që kjo vlerë të ulet, duke bërë rivlerësim të saj.

Në pikën nr.8, Kreu i I-rë, i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.741, datë 09.09.2015 "Për miratimin e formës, rasteve dhe mënyrës së llogaritjes të garancive financiare për rehabilitimin e mjedisit, për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e investimeve në veprimtarinë minerare" thuhet:

"Për vitin e dytë dhe në vazhdim, për lejet minerare të shfrytëzimit dhe lejet e kërkim-zbulim-shfrytëzimit, vlera e garancisë rivlerësohet dhe përcaktohet nga AKBN-ja, në përputhje me sasinë e mineralit të parashikuar për t'u shfrytëzuar në planin vjetor, nëse kjo sasi është më e madhe se sasia e programuar në projektin e zhvillimit të veprimtarisë minerare. Garancia financiare vjetore depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, lëshohet në favor të ministrisë përgjegjëse për veprimtari në minerare dhe dokumenti i garancisë depozitohet në AKBN dhe në ministrinë përgjegjëse për veprimtarinë minerare, jo më vonë se 20 ditë kalendarike pas përfundimit të vitit paraardhës, i cili përlllogaritet duke filluar nga data efektive e marrjes së lejes minerare".

Pra, siç shikohet nga baza ligjore në fuqi nuk është e mbështetur në ligj, ulja e vlerës së garancisë mjedisore vjetore të llogaritur në përfundim të periudhës një vjeçare nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, e për rrjedhojë edhe për lejen minerare nr.1043, datë 20.07.2007, për mineral hekur nikel dhe nikel silikat, në objektin "Bitinckë", Devoll, Korçë, që shoqëria juaj zotëron. Sa më sipër, kërkesa juaj nuk mund të trajtohet".

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve, është i mbështetur në germen "ç" të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1043, datë 20.07.2007, për mineral hekur-nikel & nikel silikat, në objektin "Bitinckë", Devoll, Korçë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1043, datë 20.07.2007, për mineral hekur-nikel & nikel silikat, në objektin "Bitinckë", Devoll, Qarku Korçë.

Në zbatim të nenit 49, të Ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI

BELINDA BALLUKU

ME AUTORIZIM

ZËVENDËS MINISTRI

